<p>Artikull me rezultate origjinale shkencore/profesionale, i botuar në përmbledhje kumtesash nga tubime shkencore/profesionale me këshill redaktues ndërkombëtar</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) <i>Leksiku antroponimik në arealin e Maqedonisë, “Albanologjia” Vol. 3, nr. 5-6, Tetovë 2016, fq. 69-74</i> 2) <i>Për një karakteristikë gramatikore ballkanike, “Albanologjia” Vol. 4, nr. 8, Tetovë 2017, fq. 13-23</i> 3) <i>Rreth standardit të shqipes në medie, “Albanologjia” Vol. 6, nr. 11-12, Tetovë 2019, fq. 211-224</i> 	3 x 3=9
<p>Pjesëmarrje me referat në tubim shkencor/profesional</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) <i>Seminari VII Ndërkombëtar i Albanologjisë, „Prurjet e kulturës shqiptare gjatë shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI“, Universiteti i Tetovës – Tetovë, 27 shtator 2013</i> 2) <i>Konferenca shkencore „Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni,, ITSHKSH-Shkup, Shkup, 30 shtator 2014</i> 3) <i>Konferenca shkencore „Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë“,ITSHKSH, Shkup, 21 nëntor 2014</i> 4) <i>Seminari IX Ndërkombëtar i Albanologjisë, „Lokalja dhe universalja në kulturën shqiptare“ Universiteti i Tetovës – Tetovë, 2-3 tetor 2015</i> 5) <i>Seminari X Ndërkombëtar i Albanologjisë, „Letërsia shqipe në shekullin XX“, Universiteti i Tetovës – Tetovë, 30 shtator 2016</i> 6) <i>Paneli shkencor „Gjuha shqipe ne Maqedoni – histori dhe</i> 	11x1=11

<p><i>perspektiva</i>” ITSHKSH, SHkup, 18 qershor 2018</p> <p>7) Seminari XII Ndërkombëtar i Albanologjisë, „Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë“, Universiteti i Tetovës – Tetovë, 28 shtator 2018</p> <p>8) Simpoziumi ndërkombëtar shkencor „Балканската историографија и современите предизвици“, По повод 70 години од основањето на Институтот за Национална Историја, Instituti i Historisë Nacionale, Universiteti „Sh. Cirili e Metodi” Shkup, 9-10 nëntor 2018</p> <p>9) Konferenca shkencore „Kolë Bojaxhiu – atdhetari shkupjan“, Me rastin e 100 – vjetorit të vdekjes, ITSHKSH – Shkup & IK Shtëpia përkujtimore e Nënës Tereze – Shkup, 1 gusht 2019</p> <p>10) Tubimi ndërkombëtar shkencor „Македонскиот јазик во споредбените лингвистички истражувања“, Instituti i Gjuhës Maqedonase „Krste Misirkov”, Universiteti „Sh. Cirili e Metodi” Shkup, 27-28 maj 2019</p> <p>11) Sesioni shkencor „Kontributi i prof.. Remzi Nesimit për gjuhën dhe gjuhësinë shqiptare “ITSHKSH, Shkup, 21 mars 2019</p>	
<p>Udhëheqës i projektit shkencor nacional</p> <p><i>Emrat vetjakë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore e shpirtërore të Maqedonisë, Ministria e Kulturës së R. së Maqedonisë së Veriut, 2019</i></p>	1x6=6
<p>Ligjëratë plenare në tubim shkencor/profesional</p> <p>Panel diskutimi „Roli i femrës shqiptare në shoqëri –Cili është rrëfimi yt?!” ITSHKSH, Shkup, 8 mars 2019</p>	1x2=2
Gjithsej	92

VEPRIMTARIA ARSIMORE

	Pikë
Mbajtja e ligjëratave	
- studime të ciklit të parë: - lënda mësimore:	
4) “Shkrimi akademik” (2+1)	128x0,04=5,12
5) “Metodologjia e hulumtimit shkencor”(2+1)	128x0,04=5,12
6) “Metodologjia e shkrimit ligjor”(2+1) (semestri dimëror dhe semestri veror; viti akademik 2017/2018; 2018/2019) Kolegji “Biznesi”, Prishtinë	128x0,04=5,12
Mbajtja e ushtrimeve (viti akademik: 2017/2028; 2018/2019)	192x0,03=5,76
Gjithsej	21,12

VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

	Pikë
Anëtar i këshillit redaktues të revistave shkencore/profesionale 1) „Studime albanologjike” бр. 15 – 2017 2) „Studime albanologjike” бр. 16 - 2018 3) „Studime albanologjike” бр. 17 - 2018 4) „Studime albanologjike” nr. 18 – 2018 5) „Studime albanologjike” nr. 19 – 2019	5x0,5=2,5
Kryeredaktor i përmbledhjeve të punimeve nga tubimet shkencore/profesionale 1) „Scupi” nr. 24 – 2019	1x2=2
Anëtar i redaksisë së përmbledhjeve të punimeve të konferencave shkencore/profesionale 1) „Scupi” nr. 8 – 2015 2) „Scupi” nr. 9 – 2015 3) „Scupi” nr. 13 – 2015 4) „Scupi” nr. 17 – 2017 5) „Scupi” nr. 22 – 2018 6) „Scupi” nr. 26 – 2019	6x1=6
Redaktor ose recensent i librave shkencorë ose profesionalë 1) B. Baliu, <i>Onomastika dhe dokumenti</i> , Prishtinë, 2016 2) B. Ymeri, <i>Shqiptarët e Maqedonisë në trojet rumune</i> , ITSHKSH, Shkup, 2017 3) Sh. Ajdini-Murtezi, <i>Problemet gjuhësore në fushën e mësimdhënies së gjuhës frënge në shkollat e mesme shqipe në Maqedoni</i> , ITSHKSH, Shkup, 2019	3x0,5=1,5
Redaktor gjuhësor i librave shkencorë ose profesionalë 1) R. Useini, <i>Veshjet popullore shqiptare të rajonit të Strugës</i> , ITSHKSH, SHkup, 2017 2) B. Mustafa, I.Murtezani, R.Useini, <i>Gjurmëve të veshjes popullore shqiptare në Maqedoni</i> , ITSHKSH, Shkup, 2017 3) B. Mustafa, <i>Patishka – dëshmi e gjallë gjuhësore e etnokulturore në Karshiakë</i> , ITSHKSH, SHkup, 2018 4) Mumin, Shutaj, <i>Gjurmë nga trashëgimia. Fjalë të urta popullore shqiptare</i> , Kumanovë – Preshevë, 2019 5) I. Azizi & S. Asani, <i>Kontesti kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe</i>	5x0,5=2,5

<i>Mbretërisë së SKS-së (1919-1925), ITSHKSH, Shkup, 2019</i>	
Kryetar i këshillit organizues ose programor i një tubimi shkencor/profesional 1) <i>Kontributi i prof.. Remzi Nesimit për gjuhën dhe gjuhësinë shqiptare, ITSHKSH, Shkup, 2019</i>	1x1=1
Anëtar i i këshillit organizues ose programor i një tubimi shkencor/profesional 1) <i>Gjuha shqipe në Maqedoni – histori dhe perspektiva, ITSHKSH, Shkup, 2018</i> 2) <i>Akademi shkencore dhe sesion shkencor me rastin e 110-vjetoritë Kongresit të Manastirit, ITSHKSH, Shkup, 2018</i> 3) <i>Dasmat në trevat shqiptare, ITSHKSH-Shkup, 2019</i> 4) <i>Roli i femrës shqiptare në shoqëri – Cili është rrëfimi yt?!, ITSHKSH, Shkup, 2019</i> 5) <i>Etnokultura e trevës së Gostivarit, SHESH “Etnoalb”, 2019</i> 6) <i>Ditët e alfabetit, ITSHKSH, Shkup, 2019</i>	6x0,5=3
Anëtar i Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptaërve – Shkup	2
Udhëheqës i Sektorit të Gjuhës shqipe në ITSHKSH-Shkup (2018-2019)	3
Anëtar i komisioneve në Institut 1) <i>Anëtar i komisionit për evaluim të brendshëm, ITSHKSH, Shkup, 2017</i> 2) <i>Anëtar i komisionit për evaluim të brendshëm, ITSHKSH, Shkup, 2018</i>	2x1=2
Anëtar i komisionit për zgjedhje në thirrje 1) <i>Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtor shkencor të dr. Shpresa Mehmetit në ITSHKSH-Shkup, 2018</i> 2) <i>Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtor shkencor të dr. Shejnaze Ajdinit në ITSHKSH-Shkup, 2018</i> 3) <i>Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje asistent hulumtues shkencor të mr. Idaete Sinanit në ITSHKSH-Shkup, 2018</i> 4) <i>Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje asistent i ri të Lindita Ahmetit në ITSHKSH-Shkup, 2019</i>	4x0,2=0,8
Pjesëmarrje në komisione të organeve shtetërore e të organeve të tjera 1) <i>Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje dhe rizgjedhje në thirrje profesionale në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës në R. e Maqedonisë së Veriut (2018-2020)</i>	1x0,2=0,2
Gjithsej	26,5

REFERENCA PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE	Pikë
VEPRIMTARIA HULUMTUESE SHKENCORE	92
VEPRIMTARIA ARSIMORE	21,12
VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	26,5
Gjithsej	139,62

Shkup, 20.12. 2019

Komisioni recensues:

1. prof. dr. Qemal Murati, kryetar, d.v.
2. prof. dr. Asllan Hamiti, anëtar, d.v.
3. dr. Zeqirija Ibrahimimi, anëtar, d.v.

R E F E R A T

**PËR ZGJEDHJEN / RIZGJEDHJEN E NJË ASISTENTI HULUMTUES
NË DEPARTAMENTIN E ETNOLOGJISË, HISTORISË SË ARTIT
DHE ARKITEKTURËS POPULLORE NË INSTITUTIN E TRASHËGIMISË
SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP**

Në bazë të shpalljes së konkursit publik më 13.11.2019 në gazetën ditore “Koha”, “Nova Makedonija” dhe në faqen e internetit (www.itsh.edu.mk), për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje shkencore të një asistenti hulumtues në Departamentin e Etnologjisë, Historisë së Artit dhe Arkitekturës Popullore, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, në mbledhjen e tij të rregullt nr. 154, të mbajtur më 02.12.2019, mori vendimin nr. 0201-803/4, me të cilin na zgjodhi për anëtarë të Komisionit recensues në këtë përbërje: dr. Izaim Murtezani - këshilltar shkencor - kryetar i komisionit, dr. Bukuriye Mustafa - këshilltare shkencore – anëtar, dhe prof. dr. Hiriet Ziberi - anëtar.

Duke iu falënderuar për besimin e dhënë, si dhe pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup në vijim ia paraqesim këtë:

R A P O R T

Pasi që Komisioni recensues e kontrollon dokumentacionin e dorëzuar, konstatoi se për zgjedhjen/rizgjedhjen e një asistenti hulumtues në Departamentin e Etnologjisë, Historisë së Artit dhe Arkitekturës Popullore në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, u paraqit vetëm një kandidat: **Mr. Rini Useini**.

3. TË DHËNA BIOGRAFIKE

Kandidati mr. Rini Useini është i lindur në f. Koroshishtë të Strugës ku e ka kryer edhe shkollimin fillor, kurse shkollimin e mesëm e ka filluar dhe mbaruar në SHMSH “Niko Nestor” në Strugë. Studimet themelore i kreu në Universitetin e Prishtinës, përkatësisht në departamentin e Etnologjisë, ku u shpërblye si student më i mirë i Fakultetit Filozofik në vitin akademik 2005/2006. Studimet pasdiplomike i kreu në Institutin e Folklorit “Marko Cepenkov” në Shkup, kurse studimet e doktoraturës i vazhdon në Institutin e Etnologjisë dhe Antropologjisë në Shkup.

Paraprakisht ka punuar si gazetar dhe udhëheqës televiziv në “Art Kanal” në Strugë si dhe në revistën kulturore të Kosovës “Pena shqiptare”. Nga viti 2008 është punësuar në kuadër të departamentit të Etnologjisë, Historisë së Artit dhe Arkitekturës Popullore në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup ku edhe aktualisht vazhdon të punojë në cilësinë e asistentit hulumtues. Tashmë mr. Rini Useini, siç cekëm më sipër, është duke ndjekur studimet e doktoraturës në semestrin e fundit në fushën e Etnologjisë dhe Antropologjisë në kuadër të Institutit të Etnologjisë dhe Antropologjisë në Univeristetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Instituti Albanologjik i

Prishtinës, pastaj në diskutimet e organizuara nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit – Tiranë, po ashtu edhe në konferenca shkencore me karakter ndërkombëtar, si konferenca për trashëgiminë kulturore në Hangzhou në Kinë në vitin 2018, pastaj në konferencën “Festivali i 7 ndërkombëtar i trashëgimisë kulturore” në Chengdu të Kinës në vitin 2019 e kështu me radhë.

Mr. Rini Useini ka qenë anëtar i Këshillit artistik të festivalit “Këngë Jeho” të Strugës në vitet: 2015, 2016, 2017, 2018, 2019. Ai ka botuar punime në revistën “Scupi” dhe “Studime Albanologjike” të ITSHKSH-së, si dhe në përmbledhësin e punimeve shkencore “Albanologjia” të Institutit Albanologjik të Prishtinës, pastaj në revistën etnokulturore “Etnoalb”, revistën “Kërkime historike”, etj.

4. VEPRIMTARIA SHKENCORE HULUMTUESE

Kandidati Rini Useini është edhe autor / bashkautor i monografive shkencore, i disa punimeve nëpër revista të ndryshme shkencore, është pjesëmarrës në konferenca dhe aktivitete vendore e ndërkombëtare, si dhe pjesë e disa projekteve hulumtuese shkencore nga sfera e interesimit të tij:

2.1. Monografi shkencore (libra)

- 3.1.1. “Gjurmëve të veshjes popullore shqiptare në Maqedoni” (në bashkëautorësi me dr. Bukurie Mustafa dhe dr. Izaim Murtezani), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2017.
- 3.1.2. “Veshja popullore shqiptare në trevën e Strugës”, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2018.
- 3.1.3. “Албанските народни носии во Струшко”, Скопје, 2019.

3.2. Punime në revista të ndryshme shkencore

- 3.2.1. *Etnologjia si manifestim në kohët e sotme në religjion, turizëm, shoqëri, etj*, “Albanologji”, VII. 1, nr. 2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2014.
- 3.2.2. *Mbi kujtesën apo ngulmin - manifestimi i sotëm i veshjes popullore*. “Scupi” - 9, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2015.
- 3.2.3. *Aktivitetet e shoqërive dhe zhvillimet kulturore në Shkup e rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore, shikuar nga këndvështrimi etnografik*, “Kërkime historike”, 9-10, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni.
- 3.2.4. *Burri dhe gruaja në punët e tjetrit*, “Albanologjia”, - 6, vëllimi II, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2016.
- 3.2.5. *Zbukurimi apo maskimi i fytyrës te nuset në trevën e Kërçovës*. “Etnoalb” - 1, Revistë shkencore për folklor dhe etnologji, Shoqata e etnokulturës shqiptare “Etnoalb” – Shkup, 2017.
- 3.2.6. *Këndveshtrim antropologjik mbi këngët e dasmës në trevën e Dibrës*, “Etnoalb” - 2, Revistë shkencore për folklor dhe etnologji, Shoqata e etnokulturës shqiptare “Etnoalb” – Shkup, 2018.

- 3.2.7. *Vështrim ekonomik-antropologjik te dasmat bashkëkohore në Gostivar dhe rrethinë*, “Etnoalb” - 3, Revistë shkencore për folklor dhe etnologji, Shoqata e etnokulturës shqiptare “Etnoalb” – Shkup, 2019.
- 3.2.8. *Religjionet popullore në festat popullore kalendarike*, “Scupi”, 18, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2017.
- 3.2.9. *Dita e verës në Strugë dhe simbolika e saj*, “Scupi” 15, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2018.
- 3.2.10. *Shën Gjergji, identitet brezash (rasti i fshatit Koroshishtë)*, “Scupi” - 21, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2019.
- 3.2.11. *Vështrim antropologjik i çështjeve ekonomike të dasmave bashkëkohore shqiptare*, “Scupi” - 26, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2019.

3.3. Pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare

- 3.3.1. Panel diskutimi “Përthyerje antropologjike” - Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Tiranë, dhjetor, 2017; Pjesëmarrës me temën: “Veshja në konotacion me trupin”
- 3.3.2. 16 International “Border Crossings” Student Conference- organized by Institute of Ethnology and Anthropology, Skopje: „Balkan Cultural Heritage. Borders, boundaries, images, interpretations, protection practices and tourists perspectives” (26-29 april 2018); Pjesëmarrës me temën: „Economic religion rights in contemporary marriages”.
- 3.3.3. [“7 th China International Festival of the Intangible Cultural Heritage”](#); Pjesëmarrës me temën „Craft of Hats in Conflict with Modernisation”, Chengdu, China 2019.
- 3.3.4. Punëtori nga Dariah Eric - Ndërtimi i infrastukturës përmbajtësore për institutet nga fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, 2017; Pjesëmarrës me temën „Njohja e tjetrit në tekstet shkollore”
- 3.3.5. Seminari IX Ndërkombëtar i Albanologjisë, Universiteti Shtëror i Tetovës, me temën boshte „Lokalja dhe universalja në kulturën shqiptare” (2-3 tetor 2015); Pjesëmarrës me temën „Femrat dhe roli i tyre në kanunet shqiptare”
- 3.3.6. Seminari X Ndërkombëtar i Albanologjisë me temën “Letërsia shqipe në shekullin XX” (30 shtator - 1 tetor, 2016); Pjesëmarrës me temën „Mitologjia ekzistenciale dhe mbishtresimi i saj”
- 3.3.7. Konferenca shkencore e Institutit Albanologjik të Prishtinës “Java e Albanologjise – 2016 (Maj 2016); Pjesëmarrës me temën „Transmetimi i kulturës shpirtërore ndër gjenerata”
- 3.3.8. Konferenca shkencore e Institutit Albanologjik të Prishtinës, “Java e Albanologjisë” (prill 2018); Pjesëmarrës me temën: „Manifestimet kulturore në Strugë, bashkëpunim komunitetesh dhe atraksion turistik”

- 3.3.9. Konferenca shkencore “Rëndësia e mbledhjes dhe studimit të folklorit dhe etnografisë”, në organizim të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve, me seli në Shkup, (Kumanovë, më 22 tetor 2016); Pjesëmarrës me temën “Kujtesa shoqërore si ruajtje e kulturës shpirtërore”
- 3.3.10. Qendra regjionale për trashëgimi kulturore - Pejë, konferenca shkencore “Rugova, thesar i trashëgimisë kulturore”; Pjesëmarrës në cilësinë e diskutuesit profesional në panel
- 3.3.11. Konferencë shkencore “70 vjetori i ansamblit Rugova” (2 dhjetor 2017, Pejë); Pjesëmarrës me temën “Veshja e Rugoves dhe Strugës në vështrim krahasues”
- 3.3.12. „2nd China-CEEC Expert-Level Forum on Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage”, Hangzhou, Zhejiang, China (from September 17th to 22nd); Pjesëmarrës me ekspozitë të veshjeve të Kërçovës dhe punime manifakturale.
- 3.3.13. Konferenca shkencore “Java e Albanologjisë”, organizuar nga Instituti Albanologjik (18 qershor, 2019). Pjesëmarrës me temën “Marrëdhëniet e reja ndërshqiptare pas ekzodit të vitit 1999”
- 3.3.14. Konferenca shkencore me temë “Veshja shqiptare e Medvegjës dhe viseve tjera” (2 maj, 2019); Pjesëmarrës me temën “Veshja e Medvegjës dhe viseve tjera si elemente ndërlidhëse me identitetin”

3.4. Pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete vendore

- 3.4.1. Pjesëmarrës në konferencën shkencore “Etnokultura ne trevën e Gostivarit dhe Rekës së Epërme” nën organizim të Shoqatës së Etnokulturës Shqiptare “Etnoalb” me seli në Shkup.
- 3.4.2. Pjesëmarrës në konferencën shkencore “Dasmat në trevat shqiptare”, ITSHKSH - Shkup, (3 maj, 2019);
- 3.4.3. Pjesëmarrës në konferencën shkencore “Festat e kalendarit popullor - Dita e Shën Gjergjit”, ITSHKSH- Shkup në bashkëpunim me komunën e Tetovës (7 maj, 2018);
- 3.4.4. Pjesëmarrës në konferencën shkencore “Dita e Shën Gjergjit në trevat shqiptare” (maj, 2018 në Tetovë).
- 3.4.5. Anëtar i Këshillit artistik në Festivalin e Këngëve dhe Valleve të Përpunuara “Këngë Jeho” - Strugë, në vitet 2015, 2016, 2017, 2018, 2019.
- 3.4.6. Anëtar i komisionit për thirrje shkencore në fushën e Etnologjisë dhe Muzeologjisë në Ministrinë e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.
- 3.4.7. Anëtar i Këshillit organizativ të manifestimit “Ditët e Alfabetit” (14-22 nëntor 2019), ITSHKSH-Shkup.

3.5. Projekte shkencore

- 3.5.1. *Kultura dhe folklori i shqiptarëve në kohën e ish-Jugosllavisë* – projekt i financuar nga Ministria e Kulturës për vitin 2017

- 3.5.2. *Martelat e përziera në kohën e ish-Jugosllavisë* - projekt i financuar nga Ministria e Kulturës për vitin 2017
- 3.5.3. *Vështrim antropologjik në mjedis kulturor të përzier* - projekt i financuar nga Ministria e Kulturës për vitin 2019
- 3.5.4. *Njohja me identitetin kulturor të tjetrit* - projekt i financuar nga Ministria e Kulturës, "Vala Kulturore – 2019"
- 3.5.5. *Transmetimi i trashëgimisë kulturore* - Projekt nga Ministria e kulturës "Vala Kulturore - 2019".

Nga njësitet e mësipërme bibliografike mund të vërehet se kandidati mr. Rini Useini ka marr pjesë në konferenca të ndryshme shkencore dhe aktivitete të përmasave tjera, kryesisht nga fusha e etnologjisë që është edhe vokacioni i tij profesional. Nga aktivitetet e kësaj natyre vlen të veçohet, sidomos pjesëmarrja në konferencën shkencore në Kinë, por edhe pjesëmarrja në aktivitetet shkencore të zhvilluara në Prishtinë, të organizuara nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, si dhe pjesëmarrja në disa veprimtari shkencore të zhvilluara në Tiranë.

Në kuadër të bibliografisë së tij shkencore vlen të ceket, sidomos publikimi i monografisë shkencore me titull *Veshja popullore shqiptare në trevën e Strugës*, të botuar në Shkup në vitin 2018 nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Nëpërmjet kësaj monografie shkencore përdëftohet se kandidati mr. Rini Useini i zotëron në mënyrë solide aspektet metodologjike, por edhe ato teorike të disiplinës së etnologjisë, por edhe të disiplinave tjera simotra të saj. Në këtë kontekst duhet të përmendet edhe fakti se kjo monografi shkencore është publikuar edhe në gjuhën maqedonase duke e zgjeruar dukshëm hapësirën e saj komunikuese.

Gjithashtu në suaza të bibliografisë shkencore duhet të veçohet edhe publikimi *Gjurmë të veshjes popullore shqiptare në Maqedoni* të botuar në Shkup, në vitin 2017, në bashkëautorësi me dr. Bukuriye Mustafën dhe dr. Izaim Murtezanin. Në këtë monografi shkencore, kandidati mr. Rini Useini shtjellon çështjen e përpunimit të veshjeve popullore duke përdëftuar me këtë rast se posedon njohuri të theksuara empirike si rrjedhojë e ekspeditave të tij shkencore, të zhvilluara në vise të ndryshme, të banuara kryesisht me popullatë shqiptare.

Edhe punimet tjera shkencore të botuara në revistat e ndryshme shkencore në Shkup dhe Prishtinë, por edhe gjetiu flasin se kandidati u qaset në mënyrë serioze problemeve shkencore duke i trajtuar ato me një përkushtim të veçantë, por edhe me një tentativë për të depërtuar në esencën e brendisë së tyre. Njëkohësisht mund të vërehet edhe tendenca e drejtë e klasifikimit të materies studimore, si dhe analizimi i saj në bazë të një bibliografie të begatshme – tipike për lëminë e etnologjisë dhe antropologjisë kulturore.

4. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të të dhënave të dorëzuara, si dhe në bazë të mbikqyrjes së veprimtarisë shkencore të kandidatit mr. Rini Useini, nënkuptohet në periudhën kohore nga zgjedhja e tij e fundit në thirrjen shkencore të asistentit, komisioni konstatoi se kandidati në fjalë deri më tani ka manifestuar vullnet, dëshirë dhe ambicie në avancimin

e tij akademik që paraqet një lloj baze solide për karrierën e tij të mëtejme, si dhe vijimin e suksesshëm të punës hulumtuese dhe shkencore.

Andaj, në pajtim me Rregulloren për kushtet e kriteret, procedurën dhe mënyrën e përzgjedhjes në thirrjet arsimore-shkencore dhe në pajtim me Ligjin e veprimtarisë shkencore dhe hulumtuese, Komisioni recensues i propozon Këshillit të Institutit ta rizgjedh kandidatin mr. Rini Useini për asistent-hulumtues në Sektorin e Etnologjisë, Historisë së artit dhe Arkitekturës popullore në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup.

25.12.2019, Shkup

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Izaim Murtezani – kryetar, d.v.
2. Prof. dr. Bukurie Mustafa – anëtar, d.v.
3. Prof. dr. Hiriet Ziberi – anëtar, d.v.

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN/ RIZGJEDHJEN E NJË ASISTENTI HULUMTUES NË
DEPARTAMENTIN E HISTORISË SË SHQIPTARËVE NË MAQEDONI DHE
LËVIZJET DEMOGRAFIKE NË INSTITUTIN E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, me vendim nr.0201-803/3 të datës 02.12.2019, na zgjodhi në cilësinë e anëtarëve të Komisionit recensues në përbërje: prof. dr. Naim Alimi – këshilltar shkencor, prof.as.dr. Isamedin Azizi – bashkëpunëtor i lartë shkencor, dhe doc.dr. Munir Ademi - bashkëpunëtor shkencor, për zgjedhjen/rizgjedhjen në thirrjen shkencore asistent hulumtues në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve–Shkup.

Në konkursin e shpallur në gazetata ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” të datës 13 nëntor 2019, për zgjedhjen/ rizgjedhjen e një asistenti hulumtues në Departamentin e Historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjet demografike, është paraqitur kandidati **mr. Agron Salih**, asistent hulumtues në IPSH Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, kemi nderin që Këshillit të Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup t’ia paraqesim në vijim këtë:

R A P O R T

I

Mr. Agron Salih është i lindur më 05.04.1974 në f. Sllatinë, Tetovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Tetovë. Në vitin 2000 u diplomua në Universitetin Shtetëror të Tetovës, drejtimi: gjeografi. Në vitin 2013, në fakultetin e njëjtë mbrojti me sukses tezën e magistraturës me titull: “**Lëvizjet demografike në regjionin e Pollogut (1953-2002)**”, nën kujdesin e mentorit prof. dr. Fauzi Skenderi. Në periudhën 2006-2007 punoi si mësues i gjeografisë në Shkollën fillore “Kirili dhe Metodi” në Tetovë.

Nga viti 2008 është angazhuar në cilësinë e asistentit të ri hulumtues në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

II

Kandidati mr. Agron Salih, krahas formimit të tij shkencor e profesional, preokupimin e tij shkencor e orienton në drejtim të hulumtimit të lëvizjeve demografike në Republikën e Maqedonisë. Ai pikëpamjet dhe qëndrimet e tij i ka prezantuar në disa punime të botuara.

Ka marrë pjesë në disa projekte hulumtuese dhe ka publikuar disa punime nga fusha me të cilën merret. Në revistën “Zaman” në vitin 2015 e ka publikuar punimin e tij me titull “Komuna e Çairit me popullatë më të dendur në Evropë”. Gjatë vitit 2004 ka punuar si koordinator në projektin për natyrën “Ndikimi i planit lokal në mjedisin jetësor” (projekt për ekologji në Komunën e Tearcës). Në vitin 2011 në revistën shkencore të botuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, “Studime Albanologjike”, nr. 3 ka publikuar punimin e tij shkencor me titull “Karakteristikat demografike të Pollogut (1953-2002)”.

Ka marrë pjesë në konferencën shkencore “Trashëgimia kulturore dhe turizmi në Maqedoni” (Strugë, 23-24.06.2012) me temën “Kapacitetet e Komunës së Tearcës për thithjen e turistëve”, e cila është publikuar në përmbledhjen e punimeve shkencore “Scupi”, nr. 3, 2012. Ka botuar punimin shkencor “Ndryshimet demografike në Shkup në periudhën 1948-1971”, në revistën “Kërkime Historike”, Shkup 2013; pastaj punimin “Toponimia në fshatin Sllatinë-Tetovë”, në edicionin e ITSHKSH-së “Scupi”, 5, 2017.

Referues në tribunën shkencore organizuar nga Shoqata për kulturë dhe art “Tradita” në Tetovë, me titull “Roli i monumenteve historike në zhvillimin e turizmit kulturor në Tetovë”, 2017.

Mr. Agron Salih i ka qenë i angazhuar në cilësinë e bartësit të projektit me interes nacional në kulturë: “70 vjet nga botimi i gazetës Flaka e Vllazërimit” në vitin 2015.

Nga angazhimet tjera, veçojmë: Anëtar i këshillit redaktues të revistës shkencore “Scupi” e botuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup: nr. 18, 2017; në cilësinë e sekretarit të revistës në numrat: I/2012, II/2012, III/2012, IV/2012, VI/2014, VII/2014, VIII/2015, IX/2015, X/2015, dhe numri XIII/2015.

Anëtar i redaksisë së revistës “Kërkime Historike”, botuar nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, në numrat: IX, X, dhe XI, si dhe sekretar i revistës në numrat: VII/2013, VIII/2014/ IX – X/2017, dhe i numrit XI/ 2018.

Nga viti akademik 2015-2016 është doktorant në Institutin e Historisë Nacionale, në programin studimor “Historia Kulturore e Maqedonisë”.

Gjithashtu së shpejti priten të dalin në botim edhe dy punime shkencore me të cilat ai ka marrë pjesë në konferencat shkencore. Në aktivitetin e tij shkencor, përveç gjuhës shqipe, ka njohje solide edhe të gjuhës maqedonase dhe të asaj suedeze. Në mënyrë aktive e shfrytëzon teknologjinë kompjuteristike e cila është edhe e domosdoshme për aktivitetin e tij shkencor, si dhe ka njohuri në programet: Windows, Word, Power Point, Excel, Internet Explorer, etj.

III

Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit recensues, të cilët nga afër e përcjellin punën dhe aktivitetin e mr. Agron Salihit, dhe në bazë të raportit të paraqitur më lart, mund të konstatojmë se ai na prezantohet si një punëtor serioz, i përgjegjshëm dhe me

perspektivë, i cili mund të kontribuojë në zhvillimin e shkencës në fushën e demografisë dhe të ballafaqohet me sfidat që paraqiten gjatë punës hulumtuese-shkencore, njëkohësisht duke i plotësuar kërkesat dhe kriteret për zgjedhje në thirrjen shkencore asistent hulumtues.

Kemi nderin që Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, t'ia propozojmë që ta rizgjedhë kandidatin mr. Agron Salih në thirrjen asistent hulumtues në sektorin e Historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjet demografike.

Shkup, 10.12.2019.

Komisioni recensues:

1. Prof.dr. Naim Alimi – kryetar, d.v.
2. Prof.as.dr.Isamedin Azizi–anëtar, d.v.
3. Doc. Dr. Munir Ademi – anëtar, d.v.

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN/ RIZGJEDHJEN E NJË ASISTENTI HULUMTUES NË
DEPARTAMENTIN E HISTORISË SË SHQIPTARËVE NË MAQEDONI DHE
LËVIZJET DEMOGRAFIKE NË INSTITUTIN E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, me vendimin nr.0201-803/2 të datës 02.12.2019, na zgjodhi në cilësinë e anëtarëve të Komisionit recensues në përbërje: prof. dr. Naim Halimi, prof. dr. Isamedin Azizi, dhe doc.dr. Munir Ademi, për zgjedhjen/rizgjedhjen në thirrjen shkencore të një asistenti hulumtues në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup.

Në konkursin e shpallur në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” të datës 13 nëntor 2019, për zgjedhjen e një asistenti hulumtues në Departamentin e Historisë së Shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjet demografike, është paraqitur kandidati **mr. Ardian Limani**, asistent hulumtues në IPSH Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, kemi nderin që Këshillit të Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, t’ia paraqesim këtë:

R A P O R T

I.

Mr. Ardian Limani është i lindur më 03.12.1980 në Shkup. Shkollën fillore dhe atë të mesmen i kreu në vendlindje. Në vitin 2013 u diplomua në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin e shkencave humane, drejtimi: histori. Nga viti 2006, punoi në Shkollën Fillore “Panajot Ginovski” në Shkup. Nga marsi i vitit 2009 është punësuar në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, në cilësinë e asistentit të ri hulumtues në departamentin e Historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjet demografike. Në vitin 2014 në Fakultetin Filozofik të Universitetit Shtetëror të Tetovës me sukses mbrojti temën e magjistraturës me titull “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Sanxhakun e Shkupit në vitin 1912”.

Në zgjerimin e njohurive të veta shkencore, përveç gjuhës shqipe që është edhe gjuha amtare, shërbehet edhe me gjuhët tjera sllave, si dhe me gjuhën angleze. Në mënyrë aktive e shfrytëzon teknologjinë kompjuteristike e cila është edhe e domosdoshme për aktivitetin e tij shkencor, si dhe ka njohuri në programet: Windows, Word, Power Point, Excel, Internet Explorer, etj.

Nga numri i tretë i revistës shkencore “Kërkime Historike” që botohet nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, ai kryen detyrën e sekretarit të redaksisë shkencore, anëtarit dhe të kryeredaktorit. Si sekretar i redaksisë shkencore,

kandidati Ardian Limani paraqitet edhe në revistën shkencore “Studime Albanologjike” nr. 2, që botohet nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve–Shkup.

Nga viti akademik 2015-2016 është doktorant në Institutin e Historisë Nacionale, në programin studimor “Historia Kulturore e Maqedonisë”.

II.

Kandidati mr. Ardian Limani preokupimin e tij shkencor e orienton në drejtim të hulumtimit të historisë së shqiptarëve në shek. XIX deri në Luftërat Ballkanike, periudhë kjo që është e njohur për ngritjen e vetëdijes kombëtare të popujve ballkanik për krijimin e shteteve të tyre nacionale.

Pikëpamjet dhe qëndrimet e tij i ka prezantuar në disa punime të botuara. Si bashkautorë ka marrë pjesë në botimin e disa publikimeve: “Një shekull dashuri”, Shkup, viti: 2000; “100 vjetori i gazetës SHKUPI”, Shkup, 2011; “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Shkup 1908-1912”, Shkup, 2012.

Kandidati ka botuar edhe disa punime shkencore, si: “E vërteta e mohuar që del prej arkivit”, - Kërkime Historike, III, Shkup, 2011; “100 vjetori i gazetës SHKUPI” - Kërkime Historike, IV, Shkup, 2011; “Rregullorja e Klubit Shqiptar të Shkupit” - Kërkime Historike V-VI, Shkup, 2012; “Procesverbal i delegates shqiptare në Konferencën e Paqes të vitit 1919” Studime Albanologjike III, Shkup, 2011; “Rregullorja, programi i Organizacionit Kombëtar të Shqipërisë”, Studime Albanologjike VI, Shkup, 2012; “Organizimi territorial i vilajetit të Kosovës” – Kërkime Historike, 8, 2014; “Shkollat dhe arsimit të shqiptarët 1908-1912” – Kërkime Historike, 9-10, 2017; “Kryengritja e shtatorit sipas gazetës Politika” – Instituti i Historisë Nacionale, 2014; Ballafaqimi me të kaluarën, guximi qytetar në kohë të vështira” – ITSHKSH, 2015; “Shenjtorja nga Shkupi-korrespondenca”, Shkup, 2016; Recension “Monografi për Tanushën”, 2015; “Veprimtaria e Masar Kodrës në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup” – Scupi, 19, 2017; “Skënderbeu në Kamus Ul Alam” – Kërkime Historike, 12, 2018; “Rrethanat kulturore e arsimore në sanxhakun e Shkupit” – Kërkime Historike, 12, 2018; Recension “Marrëdhëniet politike bullgaro-shqiptare (1908-1915), Studime Albanologjike, 19, 2019; “Rrethanat politike-shoqërore e administrative në sanxhakun e Shkupit gjatë vitit 1912” – Kërkime Historike, 14, 2019.

Mr Ardian Limani ka marrë pjesë në disa projekte dhe organizime tjera shkencore si: sesione shkencore, konferenca, seminare të organizuara në vend dhe jashtë, ku janë prezantuar pikëpamjet dhe qëndrimet e tij.

III.

Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit recensues, të cilët nga afër e përcjellin punën dhe aktivitetin e mr. Ardian Limanit, dhe në bazë të raportit të paraqitur më lart, mund të konstatojmë se kandidati i plotëson kriteret për rizgjedhje në thirrjen shkencore asistent hulumtues.

Prandaj, kemi nderin që Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, t'ia propozojmë që ta rizgjedhë kandidatin mr. Ardian Limani në thirrjen asistent hulumtues në departamentin e Historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe lëvizjeve demografike.

Shkup, 23.12.2019

Komisioni recensues:

1. Prof.dr. Naim Alimi – kryetar, d.v.
2. Prof.as.dr.Isamedin Azizi–anëtar, d.v.
3. Doc. Dr. Munir Ademi – anëtar, d.v.